



KONFERENCA
Diaspora Flet

POLITIKAT EKONOMIKE
PËR INVESTIM TË DIASPORËS



PROMOVIMI I POLITIKAVE EKONOMIKE DHE INVESTIMET E DIASPORËS

17 – 20 MAJ 2018

Themelimi i Akademisë së Shkencave të të rinjve

VIZIONI

Duke marr parasysh numrin e madh të profesionistëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendlindjes por edhe atyre profesionistëve që kthehen në vendlindje për të jetuar e punuar pas një periudhe të gjatë përvojë e pune dhe dëshirës për të kontribuar në shkencë dhe universitetet bën që jo të gjithë të kenë mundësi të punojnë në drejtimin që kanë studiuar qoftë për shkak burokracisë apo edhe të mungesës së drejtimeve të caktuara për punë. Prandaj themelimi i një Akademie të tillë do të ishte një shtëpi e përbashkët e të gjithë profesionistëve të shkëlqyer që dëshirojnë të kenë karrierë akademike.

OBJEKTIVAT

1. Përmes kësaj akademie të të rinjve nga gjithë trojet shqiptare do të mundësohej grumbullimi i ekspertëve shqiptar që jetojnë jashtë dhe atyre që kanë studiuar jashtë dhe janë kthye e që janë me gradën Doktoratë apo Master shkence që kenë mundësi të kontribuojnë në zhvillimin e shkencës në vendet shqiptare duke sjellë përvojat më të mira nga vendet nga vijnë.
2. Përmes kësaj akademie do të mundësohej krijimi i mekanizmave të mirëfillta për Hulumtim dhe Zhvillim në sferat që vlerësohet nga akademica dhe shoqëria civile.
3. Nga grumbullimi i ekspertëve shqiptarë nga e mbarë bota do të krijohet mundësia e mbështetjes edhe të departamenteve të ndryshme në Universitetin Publik siç është rasti me Departamentin e Energjetikës në kuadër të Fakultetit Teknik.

HAPAT PËR REALIZIM TE PROJEKTIT:

1. Koordinimi mes tri rektorateve dhe universiteteve shqiptare nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia dhe Akademive të Shkencave nga Kosova dhe Shqipëria për themelim të Akademisë së Shkencave të të rinjve.
2. Grumbullimi i gjithë databases së ekspertëve të rinj shqiptarë nga e gjithë bota dhe mbajtja e takimit të punës për themelim të Akademisë.

3. Ndërtimi i strukturës së parë gjetja e lokacionit (si propozim dhe trekëndësh i mirë për te tre vendet mund të jetë qyteti i Prizrenit) dhe përzgjedhja e bordit dhe stafit drejtues.

ANËTARË E GRUPIT:

Lulzim Syla	NRW, Gjermani, Ellen Group – Kryesues i grupit punues
Drita Llolla	Ulqin, Mali i Zi, Projekti “STAR”, mbështetje për Reformën Administrativo-Territoriale
Skender Perpepa	Londër, Mbretëria e Bashkuar, Thornhill Shann Construction LTD
Besar Rexhepaj	Bernë, Zvicër, themelues i “Lority”
Vehap Zuka	Bad Durkheim, Gjermani, Continentale
Ingrid Mlera	Heidelbergut, Gjermani, sipërmarrëse
Alban Nevzati	Binz, Zvicër, UBS – Invenstment Baking Company
Nora Zhilivoda	Prishtinë, Kosovë
Rita Hoxha	Romë, Itali, Movimento Elle
Dhurata Hoti	Londër, Mbretëria e Bashkuar, W Diamond Group
Naim Kadishani	Toflund, Danimarkë, Tembo Construction
Fran Nikollbibaj	New York, ShBA, Financieri LLC
Niman Blakaj	New York, ShBA, Delta Properties USA, Inc
Thodhori Miho	Selanik, Greqi, Progresi Albanian Organization

DRAFT